



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.17 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të datës 07 qershor 2013,

në seancën e mbajtur më 28 qershor 2013 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

I lejohet KOSTT SH.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit si në Shtojcë të këtij vendimi.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 07 qershor 2013 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Pas vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Sistemit të Transmisionit, ZRrE ka parë të arsyeshme që të lejojë derogimin në zbatimin dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes së Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.

Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bashkangjitur Vendimit janë dispozitat ligjore për të cilat është lejuar derogimi.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtar

Krenar Bujupi, anëtar